

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E ENJTE 31 MARS 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Akti normativ nuk i ndihmon, në fakt, shtresat në nevojë. Janë krejtësisht simbolike shumat që ato do të marrin si, për shembull, 3000 lekë për një pjesë të pensionistëve. Reduktimi i tatimit mbi të ardhurat duhet bërë për të gjitha kategoritë e pagëmarrësve, sepse kanë pamundësi financiare me këto rritje të çmimeve.

Të dashur qytetarë,

Puna që Partia Demokratike ka bërë për zbardhjen e aferës më të madhe korruptive nuk mund dhe nuk duhet të baraspeshohet me arrestimet e cironkave të “rilindjes” famëkeqe. Kjo që po ndodh është për t’u përgëzuar, por nuk mjafton. Drejtësia nuk quhet e tillë nëse është selektive. Para ligjit dhe para Zotit jemi të gjithë të barabartë. Inceneratorët, edhe pse nën hetim, vazhdojnë të gllabërojnë fonde publike, ndërsa “Rilindja urbane”, e cila i ka kushtuar buxhetit të shtetit miliona euro, sot ka filluar të dalë boje. Mësova para pak kohësh se gruri na mbillet në muajin mars, zbulim i madh kjo ide, madje edhe për çmimin “Nobel”. Është për të ardhur keq kur mendon se vendi ynë ka nevojë të importojë sasi kaq të madhe gruri. Është e natyrshme të mos plotësohen dot nevojat e gjithë popullsisë me prodhim vendas, por ka qenë e domosdoshme që qeveria të hartonte një plan konkret për zhvillimin e bujqësisë dhe politikat lehtësuese, të cilat, sigurisht, do t’i kishin amortizuar sadopak dëmet e krizës aktuale.

Ultësira e Myzeqesë është lënë në harresë bashkë me fermerët dhe qeveria ende sot nuk ka asnjë plan konkret, përveç paçavureve në letër për përmirësimin e situatës. Deklarata e ministres së nderuar të Ekonomisë, për të cilën 140 euro janë më se të mjaftueshme për qytetarët, ishte sa qesharake, aq edhe e dhimbshme. Si mund të mjaftojnë 140 euro për një pensionist, të cilit ato nuk i dalin as për ilaçe, as për drita, as për ujë? Të mos flasim për biznesin. Të ndërhysh në treg duke detyruar bizneset të shesin nën çmim ose me marzh fitimi zero, është fenomen i jashtëligjshëm, i cili favorizon bizneset e oligarkëve, të cilët janë të aftë ta përballojnë këtë luhatje. Në të kundërt, bizneset e tjera shkojnë drejt falimentit. Kështu, në fakt, monopolizohet tregu, të nderuar. Në këtë formë keni vepruar edhe në shumë situata të ngjashme në vend. Sakaq, norma e TVSH-së për ushqimet është më e larta në Europë, e cila shkon deri në 20%. Po ta krahasojmë me vendet e rajonit, Kosova e ka 8% TVSH-në, Mali i Zi, 7%; Serbia 10%, ndërsa Maqedonia e Veriut e ka 5%.

Definitivisht rezultatja e këtyre shifrave është se kriza jonë është e fryrë. Qeverisë i duhet gjithmonë të ketë përballë një përbindësh me të cilin të luftojë për të justifikuar paaftësinë, dështimin dhe vjedhjet kolosale. Shumë ndodhi kishte, në fakt, në muajin mars. Pikërisht këtë muaj na u premtua nga

Kryeministri se do të dërgoheshin satelitë në orbitë. O Zot! Është sa e dhimbshme, aq edhe qesharake njëherazi. I bëj thirrje “Zeusit” të ulë satelitët në tokë dhe të mos merret më me qiejt, por me tokësorët që po vuajnë për bukën e gojës! Jeni qeveria e paradokseve të mëdha! Është mbresëlënëse të mendosh se sa të shkëputur jeni nga realiteti. E mahnitshme vërtet! Fadromat tuaj të vdekjes sot kanë kthyer buldozerët në bregdetin e Jugut për të shkatërruar vite të tëra mudi e djerse. Si përherë urdhrat vijnë nga “Blloku” i kohëve të sotme, Surreli i bijve modernë të diktaturës komuniste enveriane! Faleminderit!